

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 12 MAJ 2022

Të nderuar qytetarë,

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Në ditët që Shqipëria është në pikiatë për shkak të çmimeve të larta të shportës, të naftës, të gazit, të energjisë, të pamundësisë së biznesit për t'i përballuar, por edhe të familjarëve për t'ia dalë, qeveria shqiptare nuk ka asnjë kujdes dhe po tentohet edhe në këtë parlament të zhvendoset vëmendja në çfarëdolloj fokusi tjetër, përveç problematikave reale që kanë qytetarët shqiptarë. Projektligji, për të cilin po flasim, na rikthen një prej momenteve më të errëta të fushatës së 25 prillit, ku Partia Socialiste, me pretekstin se po përdor patronazhistë, si një formë e organizimit të fushatave elektorale, që, pa diskutim, çdo parti mund ta ketë në organizimin e vet, keqpërdori të gjitha të dhënat personale të qytetarëve shqiptarë dhe të gjitha të dhënat shtetërore, duke cenuar sigurinë kombëtare dhe duke nxjerrë në pazar pothuajse të gjitha të dhënat personalëve të qytetarëve shqiptarë, nga numrat e kartave të identitetit, pagesat që marrin nëpër institucione, të dhënat që kanë certifikatat familjare dhe personale të qytetarëve shqiptarë, duke riskuar në mënyrë të plotë çdo qytetar në këtë vend, por, siç e thashë, edhe sigurinë kombëtare.

Diskutimi se digjitalizimi po heq barrën e rëndë të qytetarëve dhe është i suksesshëm etj., në fakt, është dështim, së pari, në ofrimin e shërbimit, së dyti, në publikimin e çdo të dhëne, siç ndodhi, dhe, së treti, në keqpërdorimin e tyre, duke e kthyer në një armë në duart e militantëve të PS-së për t'u keqpërdorur në zgjedhje. Skandali i patronazhizmit nuk përfundon te patronazhistët apo te keqpërdorimi i të dhënave, por edhe më tej. PS-ja dhe qeveria, bëjnë aty ku kanë mundësi, siç po bën në këto momente dhe këto ditë Rama, (do t'i kthehem pak më pas), që jo vetëm që keqpërdori institucionet shtetërore të qeverisjes, por përdori edhe sistemin gjyqësor. Pra, ky sistem gjyqësor, që Edi Rama sot bën sikur e kritikon, e mbylli me shpejtësinë e dritës, kur thirri dy gazetarë të nderuar, të cilëve donte t'u bllokonte komplet server-in e "lapsi.al", por e ndaloi Gjykata e Strasburgut. Pra, flasim për këtë drejtësi, për të cilën bën sikur është i shqetësuar. Pa diskutim që drejtësia e keqpërdorur politikisht është një shqetësim për të gjithë dhe ne e kemi thënë.

Ne kemi thënë që drejtësia përdoret për të dënuar qytetarët, të cilët suvatojnë avllitë në vend apo ndërtojnë kasolle, ndërkohë atyre që bëjnë ndërtime shumëkatëshe pa leje në mes të ish-Bllokut, atyre që ndërtojnë nëpër aeroporte nuk u hyn gjemb në këmbë, sepse mbrohen nga qeveria. Siç e tha edhe zotëria, që bën si Ponc Pilati, i cili lan duart pasi ka kryer krimin, u dënua një këngëtar, si Bojken Lako, për shkak të dritares. Kjo është përgjegjësia e qeverisë, sepse kush nuk ka mundësi, kush nuk ka lidhje me qeverinë, kush nuk ka para për t'i dhënë një sistemi të korruptuar përfundon prapa hekurave. Nëse doni, po, ju jap të drejtë për konferencën që bëtë bashkë me ministrin e Drejtësisë, i cili i tha: “Pse nga ky me 60 metër katrorë do të nisë drejtësia, jo nga këta që kanë miliarda?!”. Është i njëjti sistem që e keni ndërtuar ju, zoti Ministër, dhe Kryeministri, i cili është kthyer si turist në Shqipëri, tani e ka avionin si lodër, vetëm me ditë e gjen në Shqipëri, se në parlament jo e jo.

Ju e keni kthyer kështu, që kush është i fortë, pavarësisht se është i korruptuar, pavarësisht se korrupsioni dhe keqpërdorimi mund të bëjnë mu në sytë e publikut, nuk preken, e nisin nga ata që kanë më pak mundësi, më pak lidhje, që janë më të mbaruar edhe politikisht, po e them siç e thotë çdo qytetar në këtë vend. Ju sot po flisni për një sukses te patronazhimi dhe për një sukses tjetër, që nuk ka ecur për shkak se ju nuk keni ndikim. A ka njëri në këtë vend që nuk e di që lufta e Edi Ramës ndaj SPAK-ut, përveçse për të hequr vëmendjen nga të gjitha problematikat që ka Shqipëria (SPAK-u dhe Presidenti, nëse doni), bëhet për tri arsye? Nuk ka qytetar që nuk e kupton se Rama ka kontroll dhe e bën për aq sa i duhet, se përndryshe hetimet do të shkonin deri në fund.

Kjo është kërkesë e të gjithë shoqërisë shqiptare, sepse paratë e taksapaguesve amerikanë, europianë, por edhe shqiptarë kanë shkuar për një drejtësi të pavarur, që t'i hetojë dhe t'i ndëshkojë deri në fund ata që kanë edhe mbrojtje politike, jo ata që nuk kanë mbrojtje, të cilët kur janë në një parti tjetër janë të këqij, kur janë te PS-ja janë të mirë. Pse e bën këtë Edi Rama? Së pari, e bën për t'u thënë partnerëve, se i ka pasur patronazhistë kryesorë, madje deri tani tre nga patronazhistët e PS-së kanë dalë përdorues dhe trafikantë droge. Së dyti, e bën që këtyre, por edhe partnerëve të tjerë që ka në çdo zonë, të cilët janë të lidhur me krimin e organizuar, por që i ka përdorur në zgjedhjet e 25 prillit, i ka keqpërdorur, duke i intimiduar votuesit nëpërmjet tyre, t'u thotë: “Jo, se po ndodhi ndonjë gjë, unë nuk kam gjë në dorë”.

Ndërkohë, operacionin “Forca e ligjit” e përdorën për të intimiduar dhe kërcënuar çdo kriminel në çdo cep të territorit për ta përdorur për PS-në, por këtu do të jemi dhe një ditë tjetër do t'i diskutojmë se sa fuqi ka pasur dhe se si edhe ndonjë emër, që e hedhin për konsum publik, se sot nuk e dëgjova ta përmendin, gjoja duan ta sjellin këtej nga PD-ja, ka mbledhur vota për PS-në, e di i madh e i vogël. Hapi i

parë që do të bëjë është t'u tregojë partnerëve të vet që nuk po i shet, por nuk ka kontroll; hapi i dytë që tenton të bëjë është t'u thotë partnerëve: "Ja, edhe unë po ju them të njëjtën gjë, unë nuk kam ndikim"; hapi i tretë është të kërcënojë Strukturën e Posaçme Antikorrupsion për t'i treguar kufijtë. Pra, ky kampioni i drejtësisë dhe kjo maxhorancë, e cila drejtësinë e kishte në fokus kryesor, tani po thotë se je në kohën shtesë dhe do të skualifikohesh.

E kërcënon me skualifikim nëse nuk i shërben PS-së apo, nëse guxon ndonjëri prej prokurorëve, me integritet në atë prokurori, që t'u shkojë hetimeve deri në fund. Me këtë mundohet t'u hedhë hi syve të gjithë shqiptarëve. Nëse doni, ndonjëri nga ju këtu mund të përgjigjet, por është fare e qartë se nuk ka mbrojtje më të mirë politike për kundërshtarin politik sesa ta sulmojë kundërshtari i vet politik. Egërsia mediatike, gjoja e sulmit politik ndaj çdo kundërshtari politik që është në këtë sallë, pa diskutim që i jep imunitet dhe e mbyll çështjen. I keni filluar akuzat nga viti '90, nga nafta dëgjova qëparë, tek akuzat e viteve 1900 deri në Mesjetë, a thua se një pjesë e madhe juaja nuk ka 30 vjet në këtë sallë; a thua se PS-ja nuk ka 9 vjet në pushtet dhe nuk ka marrë asnjë hap, as për ato që kishte prioritet dhe që gënjeu qytetarët shqiptarë se do të vendoste drejtësi, do të bënte këtë e atë? Sot është një retorikë kaq e shpifur, sa i ka bërë qytetarët shqiptarë të na shohin të gjithëve njësoj kush merret me politikë.

E ka bërë politikën më interesante Veleshnja te "Portokallia" te zona e Bërrylit sesa portokallia këtu te ne, që nuk bën për të qeshur. Kjo është situata ku e ka vendosur PS-ja të gjithë fokusin e vëmendjen. Fokusi dhe zhvendosja tjetër e vëmendjes, që tentohet të bëhet nga problemet reale, është Presidenti i Republikës. Nuk di ndonjë autoritar në ndonjë vend që t'ia japë dhe të lërë një proces të drejtë. Të gjithë autoritarët e llojit të tyre, që janë në rajon apo në zonat e tjera, që merr shembull, nga paranoja për të pasur pushtet absolut vendosin vetëm njerëzit e tyre. Në fakt, nuk është se nuk ia keni dalë, të gjitha mediet merren me këtë. Edhe ne kemi renë në këtë grackë dhe nuk po merremi me problemet reale, me skandale pas skandalesh të denoncuar në media. Në zonën time elektorale ndërkohë që buxheti për 9% të punimeve të rrugës KorçëErsekë rritet me 17 milionë euro, ka 9 vjet që nuk përfundon. Qytetarët më shkruajnë se nuk i kanë marrë ende paratë e shpronësimeve për 200 metra, dikush 300, por para për oligarkët dhe këta ka.

Para se të dilja këtu më sollën një denoncim tjetër, se si Ministria e Brendshme, mbase nuk ka pasur influencën e duhur, i kishte dhënë tenderin një kompanie që kishte 300 mijë euro më pak ofertë, por ndërkohë komisioni i prokurimit ia jepte një kompanie tjetër, që kishte 300 e ca mijë euro më shumë. Në këtë vend diskutohet vetëm se si të ndahen paratë, si të ndahet si plaçkë pasuria publike, se si të

keqpërdoren asetet shtetërore për t'i vënë në dispozicion të PS-së dhe se si të mbulohen në media dhe t'u hidhet hi syve shqiptarëve, sikur në këtë vend nuk po ndodh asgjë. Faleminderit!